

MENDIM PARALEL

Unë Valbona Sanxhaktari, anetare e trupit gjykues, nuk jam dakord me vendimin e ndërmjetëm nr.2, të trupit gjykues që ka vendosur kryerjen e procesit të rivlerësimit për gjyqtarin Artan Jahollari. Në vlerësimin tim gjyqtari Jahollari nuk ploteson kushtet e parashikuara nga neni 179/b për të qenë subjekt rivlerësimi, e për pasojë nuk duhet ti nënshtrohej këtij procesi qysh prej fillimit.

Lidhur me këtë çështje, vlerësoj se gjyqtari Jahollari ka fituar statusin e magjistratit me emërimin e tij si gjyqtar me anë të vendimit nr.13, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në kushtet kur ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” kanë hyrë në fuqi në datën 10.08.2016 dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në datën 08.10.2016, çmoj se gjyqtari Jahollari ka fituar statusin e tij pas hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016, ndaj ai nuk konsiderohet se bën pjesë në rrethin e subjekteve të përcaktuar nga këto dispozita si subjekte rivlerësimi e që duhet t’i nënshtrohen *ex officio* rivlerësimit kalimtar prej organeve të rivlerësimit.

Në optikën e nenit 179/b të Kushtetutës, i cili përcakton se subjektet e rivlerësimit janë të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë si edhe në interpretim të nenit 160 pika 2 germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim ligji nr. 96/2016), vlerësoj se gjyqtari Artan Jahollari i nënshtrohej regjimit të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016 në zbatim të kontrollit të juridiksionit të përgjithshëm dhe nuk duhet ti nënshtrohet kontrollit të posaçëm të juridiksionit të rivlerësimit.

Në vlerësimin tim Komisionit nuk ka juridiksion, e për pasojë as kompetencë lëndore për të kryer procesin e rivlerësimit për gjyqtarin Artan Jahollari. Po ashtu duke vlerësuar se procesi rivlerësimit kalimtar është një proces *ex officio* i cili gjithashtu kufizon të drejta dhe liri për kategorinë e subjekteve që i nënshtrohen procesit, është një shkak më shumë i cili nuk duhet të lejojë që me anë të vlerësimit të gjerë të situatës, me interpretim, të përfshihen në këtë proces edhe kategori të tjera të cilat nuk janë të parashikuara shprehimisht në nenin 179/b të Kushtetutës. Asnjë dispozitë e cila kufizon të drejta dhe liri themelore të garantuara me ligj nuk mund të referohet me interpretim të zgjeruar, duke përfshirë edhe raste të cilat nuk janë shprehimisht të rregulluara me ligj.

Në vijim të vendimmarrjes së trupit gjykues, e cila me shumicë votash, vendosi përfshirjen e zotit Jahollari në procesin e rivlerësimit kalimtar, jam dakord me vendimin e marr për konfirmimin e tij në detyrë.

Valbona Sanxhaktari

Komisioner
